



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0848

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Isa Hasani-Kryetarë, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani-Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Krasniqi” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i Hapsirave të brendshme, të Objekteve në QKUK” me nr. të prokurimit: “701-23-10641-2-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me datën 20.12.2023, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet si pjesërisht e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik “Krasniqi” SH.P.K. me numër;848/2023, e datës 29.10.2023, kundër, publikimit të “Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, aktiviteti prokurimit “Pastrimi i Hapsirave të Brendshme të Objekteve në QKUK “ me numër të prokurimit: “701-23-10641-2-1-1”.
2. Obligohet Autoriteti Kontraktues Qendra Klinike Universitare e Kosovës, të bëjë largimin nga Dosja e Tenderit, Kapaciteti teknik dhe profesional të kriterit “*Kërkesa 5*”, sipas konstatimeve të Panelit shqyrtues dhe të zgjasë afatin për ofertim, kriter diskriminues sipas nenit 7.5. të LPP-së.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore OE “Krasniqi” SH.P.K. sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 04.10.2023, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i Hapësirave të Brendshme, të Objekteve ne QKUK” me nr. të prokurimit: "701-23-10641-2-1-1".

OE “ Krasniqi” SH.P.K., me datën 23.10.2023 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues/ Qendra Klinike Universitare e Kosovës, e cila merr vendim të refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE “ Krasniqi” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:” Pastrimi i Hapësirave të brendshme, të Objekteve ne QKUK” me nr: "701-23-10641-2-1-1".

OE “ Krasniqi” SH.P.K. i pakënaqur me vendimin e AK-së, me datën 29.10.2023, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 848/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të me nr: "701-23-10641-2-1-1".

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 7.130.000.00 € .

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Pretendimet ankimore të operatorit ekonomik “Krasniqi” SH.P.K.

Pretendimi 1.Kerkesa mbi mundësin teknike dhe profesionale pika 9.1 dhe 9.21.Te kërkesa nr.3AK ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ketë një staf profesional si dhe të ketë përvojë në shërbimet adekuate shkollore, së paku një punëtorë të kualifikuar për sanitari apo diçka të ngjashme. Përgjigjja nga AK për këtë pyetje ka qenë: referohuni dosjes së tenderit. Të pa kënaqur me përgjigjen e AK-së në sqarimin e pyetjeve, pasi që ne, i'u kemi drejtuar AK me Kërkesë për Rishqyrtim, ku AK në vendimin e datës 26.10.2023 është përgjigjur ky pretendim i OE është i pabazuar.

Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 69 te LPP-se, pasi qe vet natyra e këtij aktiviteti te prokurimit është pastrim i hapësirave të brendshme dhe në asnjë pozicion në para masë te këtij

aktiviteti nuk është rregullimi i sanitarisë, por vetëm pastrimi i tyre. Kjo është një kërkesë e kundërligjshme të cilën AK duhet ta heq nga DT dhe NJK pasi që nuk ka të bëjë fare me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit konform nenit 25.6 të Rregullores Nr.01/2022 të KRPP-së ku thuhet: Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Pretendimi 2.AK ka kërkuar edhe ISO standardet si Menaxhimi i Cilësisë Sistemi i Menaxhimit Sistemi i menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e pastrimit, kërkon nga Operatorët ekonomik që të kenë një menagjim profesional ku lidhet direkt me shërbimin e cilësisë për shërbimet e higjienës, sepse kemi të bëjmë me largimin e mbeturinave të produkteve medicinale, ku lidhet direkt me sigurinë në punë për të gjithë punëtorët e angazhuar nga OE sepse kemi të bëjmë me pastrimin e hapësirave me rrezikshmëri të lartë nga sëmundjet e ndryshme që trajtohen pacient nëpër klinika.

Kërkesat e AK sa janë diskriminuese për OE, më tepër janë favorizuese për OE të caktuar, kritere të tilla shpërfaqin monopol në treg dhe krijojnë pasiguri për pjesëmarrje sa më të gjerë të Operatorëve Ekonomik të interesuar. Në mendojmë se këto ISO standarde janë të pa nevojshme pra kjo kërkesë është në kundërshtim me ligjin dhe si e tillë duhet të largohet nga kriteret e përzgjedhjes.

Pretendimi 3.Kërkesa 5. OE ka për obligim të angazhoi të gjithë punëtorët në shërbimet e pastrimit muajt e fundit në QKUK. Kjo kërkesë është diskriminuese sipas neni 7 LPP-së pasi që AK nuk ka të drejtë të obligoj (imponoj) OE marrjen e këtyre punëtorëve. Pra edhe kjo kërkesë është e pa nevojshme dhe duhet të largohet. Përgjigja nga AK: Ky pretendim i OE është i pabazuar sepse të gjithë punëtorët e pastrimit kanë qenë ma herët pjesë e QKUK-së dhe në momentin e kalimit të shërbimit të pastrimit të operatorët privat në të gjitha kontratat e mëhershme me operator ekonomik të ndryshëm kanë qenë të kontraktuar nga QKUK-ja kan qenë të angazhuar. Kjo kërkesë nuk ka qenë asnjëherë obligative në procedurat e mëparshme ashtu siç pretendon AK.

Pretendimi 4. Edhe për këtë kërkesë AK nuk ka dhënë sqarime në pyetjet e parashtruara për sqarime shtesë. Përgjigja e AK ka qenë: Referohuni dosjes së tenderit. Te pika 9.1 dhe 9.2 të kërkesës për kapacitete teknike dhe profesionale njoftimi për kontratë. Pra AK duhet të veproj konform LPP-se pika 4 dhe 4.2 e Nenit 69 tek, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale ku thuhet se: 4. Në procedurat që shpërndahen në dhënie të kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkojnë lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Te ndryshohen kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe AK do të veproj konform nenit 53 të LPP-së. Lidhur me aktivitetin e prokurimit: Pastrimi i Hapësirave të brendshme të Objekteve në QKUK-ë.

Vlerësimet ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0848 lidhur me pretendimet ankimore të OE “Krasniqi” SH.P.K.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 848/23, ndërsa me datë 21.11.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandim; Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar,

AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Eksperti shqyrtues -pretendimi 1, sqaron se pretendimet kryesore ankimore sipas ankesës kanë të bëjnë me kërkesat e AK-së të vendosura në dosje të tenderit për të cilat OE pretendon se janë diskriminuese dhe të panevojshme. Pas analizimit të ankesës, dosjes së tenderit dhe vendimit të AK-së në kërkesë për rishqyrtim, vlerësojmë se të gjitha kërkesat siq janë kërkesa për një punëtor të kualifikuar për sanitari, kërkesat për ISO standarde, janë kërkesa relevante dhe proporcionale në raport me lenden e kontratës përkatëse. Këto kërkesa sipas mendimit tonë janë dëshmi mbi angazhimin e OE-ve për të siguruar një organizim dhe menaxhim më të mirë të kompanisë për shërbimet të cilat ata llofrojnë, në veçanti në rastin konkret kur kemi të bëjmë me pastrimin e hapësirave me rrezikshmëri të lartë. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Eksperti shqyrtues -pretendimi 2, sqaron se kërkesa për dëshmi nga ATK për qarkullimin financiar për të cilën OE pretendon se është e pamjaftueshme për të dëshmuar përvojën e OE-ve, konsiderojmë se është e drejtë e AK-së se cilat dëshmi të parapara në LPP zgjedh ti vendos në dosje të tenderit. Në rastin konkret AK ka zgjedhur të aplikoj kërkesat në pajtim me nenin 68 par.1, nënpar.1.5 të LPP-së, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Eksperti shqyrtues -pretendimi 3, sqaron se OE ankues pretendon se kërkesa e AK-së OE se ka për obligim të angazhoi të gjithë punëtorët në shërbimet e pastrimit në muajt e fundit në QKUK. Kjo kërkesë është diskriminuese sipas neni 7 LPP-së pasi që AK nuk ka të drejtë të obligoj (imponoj) OE marrjen e këtyre punëtorëve. Pra edhe kjo kërkesë është e panevojshme dhe duhet të largohet. Ky pretendim ankimorë është vlerësojmë se është i bazuar, pasi sipas nenit 7, par.5 të LPP-së AK nuk ka të drejtë të kërkojë të punësohen persona të veçantë.

Neni 7 par.5: "Autoriteti Kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose(ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizoj produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik"

Në kuptojmë se qëllimi i AK-së është të sigurohet se punonjësve aktual të mos ju rrezikohet vendi punës, megjithatë kërkesa është e kundërligjshme, dhe një gjë e tillë eventualisht mund të arrihet vetëm me mirëkuptim në mes të OE që realizon kontratën dhe AK-së.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe kjo kërkesë duhet të largohet nga DT.

Konstatimet e panelit shqyrtues –

Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesën në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

Duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit

kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar nga ana e këtij Paneli.

Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertëve shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, ka gjetur elemente diskriminuese në këtë procese të prokurimit publik të AK.

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim.

Paneli shqyrtues vëren se në Dosjen e tenderit-Kapaciteti teknik dhe profesional, Kërkesa 5., përcaktohet se “OE ka për obligim të angazhoi të gjithë punëtorët në shërbimet e pastrimit në muajt e fundit në QKUK” konstatojmë se kjo kërkesë është diskriminuese sipas neni 7 LPP-së pasi që AK nuk ka të drejtë të obligoj (imponoj) OE marrjen e këtyre punëtorëve. Pra edhe kjo kërkesë është e pa nevojshme dhe duhet të largohet. Ky pretendim ankimorë është vlerësojmë se është i bazuar, pasi sipas nenit 7 , par.5 të LPP-së AK nuk ka të drejtë të kërkojë të punësohen persona të veçantë. Paneli shqyrtues vlerëson se çështja e punëtorëve aktual të angazhuar në punë mundet të zgjidhet me mirëkuptim përmes bisedimeve me operatorët që realizojnë kontratën dhe Autoriteti kontraktues.

Andaj përfundimisht PSH ka vendosur se, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues se Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kriterë diskriminuesë, andaj dhe AK duhet të përmitoj Dosjen e tenderit-Kapaciteti teknik dhe profesional, Kërkesa 5. dhe të zgjat afatin e ofertimit/tenderimit.

Po ashtu Paneli shqyrtues e vlerëson raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij profesional është dhënë në raportin e ekspertizës të cilën paneli shqyrtues e mbështet konstatimet e bëra në raportin e ekspertizës, me rekomandim se ankesa klasifikohet si e pjesërisht e bazuar.

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim.

- Përfundim –

Paneli shqyrtues konsideron se një pretendim ankimor është i bazuar bazuara, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK lidhur me atë nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenet 7, të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**
- **OE - "KRASNIQI"SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: